

**VENDIM**  
**Nr. 240, datë 1.4.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 6, të pikës 4, të nenit 19, të pikës 3, të nenit 21, të pikës 1, të nenit 23, të pikave 1 dhe 6, të nenit 29, të pikës 6, të nenit 33, të pikave 10 e 12, të nenit 33/1, të pikave 1 e 4, të nenit 37, të pikës 7, të nenit 56, të pikës 4, të nenit 81, të pikës 4, të nenit 84, të pikës 3, të nenit 91, dhe të pikës 1, të nenit 140, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtjen e vendimit emërtimet “ministri i Brendshëm” dhe “Ministria e Brendshme” zëvendësohen, përkatësisht, me “ministri i Punëve të Brendshme” dhe “Ministria e Punëve të Brendshme”.

2. Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimet “Ministri i Financave dhe Ekonomisë” dhe “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohen, përkatësisht, me “ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit” dhe “Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit”.

3. Në kreun II “Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

3.1. Në seksionin A bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “a”, të pikës 3, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Shtetasit e përfshirë në këtë shkronjë kanë detyrimin të dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë jo më vonë se 3 (tri) ditë nga data e përfundimit të vlefshmërisë së dokumenteve të sipërpërmendura.”.

b) Në shkronjën “b”, të pikës 3, bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “... lëshuar nga ...” shtohen “... vendet e Bashkimit Evropian, ...”. dhe pas fjalëve “... Britani e Madhe e Irlanda e Veriut ...,” shtohen “... përfshirë edhe në formatin elektronik ...”;

ii. Në fund të shkronjës “b” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Shtetasit e përfshirë në këtë shkronjë kanë detyrimin të dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë jo më vonë se 3 (tri) ditë nga data e përfundimit të vlefshmërisë së dokumenteve të mësipërme.”.

c) Në pikën 4, fjalët “... në përfaqësitë ...” zëvendësohen me “... në misionet diplomatike dhe postet konsullore ...”;

ç) Në pikën 7 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Pas fjalës “... online ...” shtohen fjalët “... duke qenë jashtë territorit të RSH-së ...”;

ii. Fjalët “... në konsullatë ...” zëvendësohen me “... në misionin diplomatik apo postin konsullor ...”.

3.2. Në seksionin B bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 3, pas fjalës “... fotokopja ...” shtohet “... e skanuar ...”;

b) Në shkronjën “a”, të pikës 5 bëhen këto shtesa:  
i. Pas fjalës “... ftesës ...” shtohet “... së skanuar ...”;  
ii. Në fund të kësaj shkronje shtohen fjalët “... me afat vlefshmërie jo më pak se 3 (tre) muaj ...”.

c) Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Vetëdeklarim për leje qëndrimi me afat mbi 12 (dymbëdhjetë) muaj, e lëshuar nga vendi ku i huaji është rezident, me vlefshmëri të paktën 3 (tre) muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar apo vizë e mëparshme apo aktuale (*Schengen*, SHBA ose Mbretëri e Bashkuar) ose viza shqiptare elektronike/pullë.”.

3.3. Në seksionin C bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 2.2, shtohen fjalët “... si dhe biletën e udhëtimit vajtje-ardhje.”;

b) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 2.3, shtohen fjalët “... me përkthim jo zyrtar në anglisht ose shqip.”;

c) Pas shkronjës “b”, të pikës 2.5, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) biletën e udhëtimit vajtje-ardhje.”.

ç) Në pikën 3, në titull, pas fjalëve “... tipit “D” ...” shtohen “... dhe leje unike për shtetasit që i nënshtrohen regjimit të vizave.”;

d) Shkronja “b”, e pikës 3.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Fotografia e aplikuesit, e cila duhet të jetë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, e marrë në plan me sfond të bardhë, e fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm, pa syze optike me ngjyrë dhe refleks.”.

dh) Shkronja “c” shfuqizohet.

e) Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.”.

ë) Në shkronjën “b”, të pikës 3.5, bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalës “... financiare ...” shtohen fjalët “... në gjuhën shqipe dhe/ose gjuhën angleze ...”;

ii. Pas togfjalëshit “... 300 000 lekë ...” shtohen fjalët “... ose në vlerën ekuivalente në euro, ...”.

f) Pas pikës 3.10/1 shtohet pika 3.10/2, me këtë përmbajtje:

“3.10/2. Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” si punëtor shtëpie (D/PSH):

a) Miratim për punësim *online* nga AKPA-ja.”.

g) Në fund të shkronjës “c”, të pikës 3.16, shtohen fjalët “... i cili lëshohet nga institucioni përkatës.”.

4. Në kreun III “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me leje qëndrimi”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

4.1. Në seksionin A bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 1/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1/1. Pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 1 (një) ditë pune të huajin me leje provizore, me afat vlefshmërie 1 (një) muaj, e cila zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e vendimit për miratimin apo refuzimin e kërkesës për pajisjen me leje qëndrimi apo leje unike.”.

b) Në pikën 6, fjalët “... kategori të veçanta ...” zëvendësohen me “... motive të tjera ...”;

c) Në fund të pikës 9 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Ky detyrim zbatohet vetëm kur shtetasi i huaj aplikon për herë të parë për leje qëndrimi apo unike.”.

ç) Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Për kategoritë e lejeve, të cilat kërkojnë dëshmi të burimeve të mjaftueshme financiare për jetesën në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë vendim, ajo konsiston në:

a) paraqitjen e një vërtetimi depozite bankare në bankat e nivelit të dytë, personale apo familjare, në Shqipëri, jo më pak se 300 000 lekë për person për 1 (një) vit kalendarik;

b) për të huajt, që qëndrojnë për motive studimi, edhe dokumentin vërtetues për burime të tjera, që rrjedhin nga një grant, një bursë studimi, një kontratë e vlefshme pune ose një ofertë pune, jo më pak se 300 000 (treqind mijë) lekë për person, për 1 (një) vit kalendarik;

c) vërtetimin e të ardhurave mujore jo më pak se paga minimale në Republikën e Shqipërisë.”.

4.2. Në seksionin B bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.”.

b) Në fund të pikës 3 shtohen fjalët “... në të cilin është përcaktuar qartë adresa e vendbanimit.”.

4.3. Nënndarja “v”, e shkronjës “ë”, të pikës 2, të seksionit C, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“v. Dokumentin se është i kategorizuar si i mitur i braktisur ose ka mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqërues për arsye të tjera dhe një kërkesë formale për leje qëndrimi nga i mituri ose kujdestari ligjor.”.

4.4. Në seksionin “Ç” bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, pas fjalëve “... e cila është e pakthyeshme ...” shtohen “... dhe është e vlefshme për një periudhë 30-ditore për riaplikim në rast refuzimi ...”;

b) Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1. Aplikimi mund të kryhet nga agjenci private të punësimit, të licencuara sipas legjislacionit shqiptar ose person i autorizuar, me kusht që ky i fundit të mos ketë marrë pjesë në procedurën e rekrutimit, por operon vetëm si përfaqësues ligjor për efekt aplikimi për llogari të punëdhënësit apo të huajit.”.

1/2. Pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 1 (një) ditë pune të huajin me leje provizore, me afat vlefshmërie 1 (një) muaj.”.

c) Në fund të pikës 5 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“... I huaji që ka marrë miratim punësimi nga AKPA-ja duhet të regjistrohet në sistemin e shërbimeve të punësimit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e lëshimit të kartës biometrike.”.

ç) Në pikën 9, fjalët “... brenda një afati maksimal prej 12 javësh ...” zëvendësohen me “... brenda afatit maksimal të përcaktuar në legjislacionin në fuqi ...”.

4.5. Në seksionin “D” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të nënndarjes “i”, të shkronjës “a”, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“... ose ofertë punësimi sipas formularit standard, në gjuhën shqipe. Në rast se aplikimi kryhet nga agjenci private punësimi e licencuar sipas legjislacionit shqiptar, ose person i autorizuar, bashkëngjitet autorizimi përkatës.”.

b) Në shkronjën “b” bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Në fund të nënndarjes “i” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“...ose ofertë punësimi sipas formularit standard, në gjuhën shqipe. Në rast se aplikimi kryhet nga agjenci private punësimi e licencuar sipas legjislacionit shqiptar, ose person i autorizuar, bashkëngjitet autorizimi përkatës.”.

ii. Pas nënndarjes “i” shtohet nënndarja “ii”, me këtë përmbajtje:

“ii. Dokument që vërteton se i huaji plotëson kushtet e përcaktuara në ligj, në rastet kur aktiviteti që do të ushtrojë bën pjesë në profesionet e rregulluara (diplomë, certifikatë profesionale ose referenca).”.

c) Në fund të nënndarjes “xii”, të shkronjës “ë”, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rast se aplikimi kryhet nga agjenci private punësimi e licencuar sipas legjislacionit shqiptar, ose person i autorizuar, bashkëngjitet autorizimi përkatës.”.

c) Shkronja “h” shfuqizohet;

d) Nënndarja “ii”, e shkronjës “c”, e kategorisë “j”, “Dokumentacioni i lejeve të qëndrimit për motive të tjera”, shfuqizohet;

dh) Pas kategorisë “j” shtohen kategoritë “k” dhe “l”, me këtë përmbajtje:

“k) Dokumentacioni shtesë për leje unike për punëtor shtëpie:

i. kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë ose ofertë punësimi, sipas formatit standard, në gjuhën shqipe. Në rast se aplikimi është kryer nga agjenci private e punësimit e licencuar, sipas legjislacionit shqiptar ose person i autorizuar, bashkëngjisni autorizimin përkatës.

l. Dokumentacioni i nevojshëm për rinovimin e lejes unike:

i. I huaji duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në legjislacionin për të huajt dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës për rinovimin e lejes unike;

ii. Në rastet kur leja unike kërkon miratim punësimi nga AKPA-ja, i huaji duhet të jetë i regjistruar në sistemin e shërbimeve të punësimit.”.

4.6. Në seksionin “DH”, pas nënndarjes “ii” shtohet nënndarja “iii”, me këtë përmbajtje:

“iii. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, dokumentacioni nga vendi i origjinës i të huajit, i dorëzuar gjatë aplikimit të parë për lëshimin e lejes përkatëse, nuk është më i nevojshëm të jetë lëshuar sipas detyrimeve të pikës 9, të kreut III, të këtij vendimi.

Në rastet e bashkimit familjar, kur martesë është lidhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe i huaji nuk mund të dorëzojë certifikatën e martesës, të lëshuar në 6 (gjashtë) muajt e fundit, apo certifikatën familjare/personale nga vendi i origjinës, i huaji/të huajt/shqiptari duhet të dorëzojë para autoriteteve vendore të kufirit dhe migracionit një deklaratë të përbashkët noteriale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, të kryer para një noteri publik shqiptar, se regjimi martesor midis tyre nuk ka ndryshuar, së bashku me një kopje të certifikatave të përkthyer në shqip nga një përkthyes i licencuar. I njëjti dokumentacion kërkohet edhe për partnerët civilë.

Për minorenët, ripërtëritja e lejes së qëndrimit kërkon miratimin noterial të të dy prindërve, i vlefshëm për 6 (gjashtë) muaj. Kjo procedurë zbatohet për të gjitha rastet e bashkimit familjar gjatë ripërtëritjeve të lejeve të qëndrimit.”.

5. Pas kreut III shtohen krerët III/1 dhe III/2, me këtë përmbajtje:

“III/1. PROCEDURA, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR LËSHIMIN E “CERTIFIKATËS SË REGJISTRIMIT” PËR SHTETASIT E VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

A. Qëllimi dhe fusha e veprimit.

1. Ky seksion përcakton procedurën e aplikimit, dokumentacionin dhe kriteret për pajisjen me “Certifikatë regjistrimi” të shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilët qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për periudha më të gjata se 3 (tre) muaj, në përputhje me nenin 33/1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar.

2. Dispozitat e këtij seksioni zbatohen vetëm për shtetasit e BE-së dhe nuk zbatohen për anëtarët e familjes që nuk janë shtetas të BE-së.

B. Procedura e aplikimit:

1. Aplikimi kryhet elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” dhe i drejtohet autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin. Aplikanti ngarkon dokumentacionin dhe plotëson formularin elektronik sipas aneksit nr. 12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pas dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionit, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin kryen verifikimin e dokumentacionit dhe të dhënave, brenda 2 (dy) ditëve punë.

3. Në rast të mangësive, aplikanti njoftohet *online* për të plotësuar dokumentacionin, brenda afatit 5-ditor.

4. Pas përfundimit të verifikimit, autoriteti për kufirin dhe migracionin i lëshon të huajit certifikatën e regjistrimit në format elektronik.

C. Kriteret dhe dokumentacioni për pajisje me certifikatë regjistrimi.

1. Shtetasi i BE-së paraqet *online* dokumentet e mëposhtme, sipas kategorisë përkatëse:

- a) Pasaportë ose letërnjoftim i vlefshëm i vendit anëtar të BE-së;
- b) Dokument që vërteton hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) Deklaratë mbi adresën e vendqëndrimit në Shqipëri;
- ç) Fotografi;
- d) Deklaratë përgjegjësie për saktësinë e të dhënave.

2. Shtetasi i BE-së pajiset me certifikatë regjistrimi nëse plotëson kushtet e një prej kategorive, si më poshtë vijon:

a) Punëmarrës ose i vetëpunësuar:

- i. kontratë pune ose deklaram për punësimin nga punëdhënësi;
- ii. dokumentacion që vërteton veprimtarinë e vetëpunësimit në Republikën e Shqipërisë;
- iii. NIPT (në rastet kur është i vetëpunësuar).

b) Person me burime të mjaftueshme:

i. deklaron dhe vërteton zotërimin e burimeve të mjaftueshme financiare për vete dhe anëtarët e familjes, që të mos bëhen barrë për sistemin e ndihmës sociale;

ii. zotëron policë të vlefshme të sigurimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

c) Student:

- i. vërtetim regjistrimi nga institucioni arsimor;
- ii. policë siguri shëndetësor;
- iii. deklaratë ose dokument provues për burime të mjaftueshme financiare.

ç) Anëtar familjeje i shtetasit të BE-së:

i. i cili shoqëron ose bashkohet me shtetasin e BE-së që plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” ose “c”, të kësaj pike; për qëllimet e këtij seksioni, kjo shkronjë zbatohet vetëm për anëtarët e familjes që kanë shtetësi të BE-së.

III/2. PROCEDURA, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR LËSHIMIN E “KARTËQËNDRIMIT TË NJË ANËTARI TË FAMILJES SË NJË SHTETASI TË BE-së

A. Kriteret për pajisjen me kartëqëndrimi të një anëtari të familjes të një shtetasi të BE-së, që nuk është shtetas i BE-së:

1. Dokumentacioni i kërkuar për t’u dorëzuar *online*.

a) Dokumentacioni bazë:

- i. dokument udhëtimi i vlefshëm (pasaportë);
- ii. fotografi;
- iii. deklaratë e adresës së përbashkët të qëndrimit në Shqipëri;
- iv. deklaratë përgjegjësie për saktësinë e të dhënave.

b) Dokumentacioni për lidhjen familjare, i legalizuar/apostiluar dhe i përkthyer në shqip:

- i. certifikatë martesë;
  - ii. certifikatë bashkëjetese;
  - iii. certifikatë lindjeje për fëmijët e bashkëshortit ose bashkëjetuesit nën 21 vjeç;
- Dokumentet e huaja duhet të jenë të legalizuara/apostiluara dhe të përkthyer në shqip.

c) Dokumentacioni i shtetasit të BE-së:

- i. kopje e certifikatës së regjistrimit;
- ii. dokument identifikimi i vlefshëm;
- iii. dëshmi të plotësimit të kriterëve sipas kategorisë së qëndrimit (punë, studime apo burime të mjaftueshme), në rast se kërkohen nga autoriteti për verifikim.

B. Procedura e aplikimit:

1. Aplikimi kryhet *online* në portalin unik qeveritar “*e-Albania*” dhe i drejtohet autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

2. Aplikanti ngarkon dokumentacionin dhe plotëson formularin elektronik sipas aneksit nr. 11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin kryen verifikimin brenda 2 (dy) ditëve punë nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë.

4. Në rast mangësish, aplikanti njoftohet elektronikisht për t'i plotësuar brenda 5 (pesë) ditëve punë.

5. Pas miratimit, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin lëshon "Kartëqëndrimin e një anëtari të familjes së një shtetasi të BE-së".

C. Revokimi:

Karta e qëndrimit revokohet nëse:

- a) shtetasi i BE-së nuk plotëson më kriteret e qëndrimit;
- b) lidhja familjare ka pushuar së ekzistuari;
- c) janë paraqitur dokumente të falsifikuara;
- ç) ekzistojnë rrethana që cenojnë rendin dhe sigurinë publike sipas ligjit."

6. Në anekset, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në aneksin nr. 6 bëhen këto shtesa:

i. Në titull, pas fjalës "... unike ..." shtohen fjalët "... si dhe certifikatë regjistrimi dhe kartëqëndrimi ...";

ii. Në tabelë, pas nr. 27 shtohet nr. 28, me këtë përmbajtje:

"28. Certifikata e regjistrimit dhe kartëqëndrimi, janë pa tarifë shërbimi."

b) Në aneksin nr. 8 bëhen këto ndryshime:

i. Në pikën 2.1, të seksionit B, kategoria "Investitor" zëvendësohet me "Punëtor shtëpie";

ii. Seksioni 2.3 "Informacion mbi punësimin" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2.3 Informacion për punësimin:

- NIPT-i i biznesit;

- Të dhënat e biznesit (me një listë e cila të thirret nga të dhënat e regjistruara në regjistrin e tatimeve për secilin biznes;

- Emri i biznesit;

- Adresa e biznesit;

- Rajoni ku e ushtron aktivitetin;

- Sektori i aktivitetit;

- Nr. i telefonit të biznesit;

- *Email*-i i biznesit;

- Pozicioni i punës në përputhje me kontratën e punës;

- Data e menduar e fillimit të punësimit;

- Data e mbarimit;

- Paga mujore bruto.

Për rinovim leje unike:

- Punëdhënës i ri/i mëparshëm;

- Pagar sigurimet për vitin paraardhës."

c) Në titullin e aneksit nr. 9, fjalët "... për kategori të veçanta ..." zëvendësohen me "... për motive të tjera ...";

ç) Në formularin "Leje qëndrimi për motive të tjera" bëhen këto shtesa:

i. Në pjesën "Karta B" shtohet kategoria "Për investitor";

ii. Në seksionin 3.1 "Arsyet e qëndrimit" shtohet kategoria "Për investitor";

iii. Në seksionin 3.4 "Të ardhurat dhe sigurimi shëndetësor" shtohen këto dokumente:

"- Vërtetim regjistrimi në QKB, me vlerën e investimit të miratuar nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për ekonominë dhe inovacionin."

## II. DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Procedura e aplikimit për lejen e qëndrimit për investitor, lejen unike për punëtor shtëpie, për certifikatë regjistrimi dhe kartëqëndrimi, sipas këtij vendimi, do të jetë funksionale pas

reflektimit në portalit unik qeveritar “e-Albania” të ndryshimeve të parashikuara në kreun III/1, seksioni B, pika 1, dhe kreun III/2, seksioni B, pika 2.

2. Kërkesat dhe procedurat administrative, që preken nga ky vendim zbatohen pas përmirësimit të sistemeve elektronike, që preken nga këto procedura.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

Formulari standard i aplikimit të kartëqëndrimit



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË  
BRENDSHME

Kartëqëndrim  
Residence Card  
Application

## APLIKIM PËR KARTËQËNDRIM / RESIDENCE CARD APPLICATION

Ky formular është për të aplikuar për kartëqëndrim në Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes dhe nënshkruani aplikimin. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Aplikimi mund të paraqitet në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit në Shqipëri, ku ju keni vendbanimin.

This form is for applying for a Albanian residence card. Carefully fill in and sign the application. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. An application may be submitted to the Regional Directorate of Border and Migration in Albania, where is your residence.

Unë po aplikoj për  
I am applying for

kartëqëndrim për herë të parë  
a first residence card

dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:  
and hereby submit the following information for the processing of my application:

### SEKSIONI A / SECTION A

1 Informacion mbi aplikantin / Information on applicant			
1.1 Informacion mbi pasaportën ose dokumentin e udhëtimit Information on Passport or travel document			
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportës: / Passport no.		
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportës Shërbimi / Official passport no.		
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportë për të huajt / Alien's passport no.		
<input type="checkbox"/>	Dokument tjetër, specifiko llojin dhe Numrin / Other, specify type and no.		
Vendi i lëshimit Country of issue	Autoriteti i lëshimit Authority of issue	Data e lëshimit Date of issue	Data e skadimit Date of expiry
1.2 Te dhëna personale / Personal data			
Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Emri i nënes Mother's name		Emri i babait Father's name	

Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shteti i lindjes Country of birth		Vendi i lindjes / Place of birth	
Gjinia /Gender: <input type="checkbox"/> Mashkull / Male <input type="checkbox"/> Femër / Female <input type="checkbox"/> E panjohur /Unknoën			
Shtetësia (të) / Current citizenship(s)			
Gjendja Civile / Civil status <input type="checkbox"/> Martuar / Married <input type="checkbox"/> Beqar / Single <input type="checkbox"/> Divorcuar / Divorced <input type="checkbox"/> I(e) Ve / Ëidoë(er) <input type="checkbox"/> Partner Civil / Civil Partner			
Profesioni dhe/ose trajnimi: Occupation and/or training:		Gjuha mëmë: Mother Tongue:	
<b>1.3 Informacioni i kontaktit të aplikantit / Contact Information of Applicant</b> Nëse informacioni i kontaktit ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj. If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.			
Adresa 1 / Address 1		Adresa 2 / Address 2	
Rruga, Nr. Street, No.			
Fshati/Qyteti - Shteti City/Toën - Country			
Tel. /Cel./Fax			
E-mail			
<b>2 Informacion mbi anëtarët e familjes / Information on family members</b>			
<b>2.1 Bashkëshorti ose Partneri civil/ Spouse or civil partner</b> <input type="checkbox"/> I pamartuar /No spouse			
Mbiemri / Family name :		Emrat / First names:	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shtetësia (te) aktuale Current citizenship(s)			
Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati) Address (street, no, city/country)			
<b>2.2 Fëmijë të mitur në kujdestari / Underage in my care</b> <input type="checkbox"/> Nuk kam fëmijë në kujdestari No children in my care			
Emri / First name	Mbiemri /Family name	Datëlindja (ddmmyyyy) Date of birth	
			<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application
			<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application
			<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application
			<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application

<input type="checkbox"/> <b>Aplikim njëkohësisht</b> Simultaneous Application
Nëse keni me shumë se pesë fëmijë, futni informacionin e fëmijëve të mbetur në një aneks të veçantë If you have more than five children, enclose the information on the remaining children in a separate appendix.
<b>2.3 Banesa / Residence</b>
Ambjenti i banimit: <input type="checkbox"/> <b>Garsonierë</b> <input type="checkbox"/> <b>Ambient kolektiv, pensione /hotel</b> <input type="checkbox"/> <b>Apartament me dhoma</b> Place of residence: Studio apartments Collective accommodation/hotel Apartment With rooms
Unë kam bashkëngjitur kontratën e qerasë / dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin I am enclosing with the application the rent contract / proof of property

## SEKSIONI B / SECTION B

<b>3. Informacion mbi qëndrimin në Shqipëri / Information on residence in Albania</b> <b>3.1 Arsyet e qëndrimit/ Grounds for residence</b>
Kur dhe në cilin PKK keni hyrë në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? / Ehen and in which BCP did you enter to Albania? Datë/Date: <input type="text"/> PKK/ BCP: <input type="text"/>
<b>3.2 Afati i qëndrimit / Terms of stay</b>
Unë aplikoj për karteqendrim me afat / I'am applying for a permit card term
<b>3.3 Unë kam bashkëngjitur vërtetimet e mëposhtme sëbashku me aplikimin:</b> <b>I am enclosing the following clarifications with my application:</b>
- Dokument udhëtimi i vlefshëm (pasaportë); Valid travel document (passport); - Fotografi; Photograph; - Deklaratë e adresës së përbashkët të qëndrimit në Shqipëri; Declaration of shared residential address in Albania; - Deklaratë përgjegjësie për saktësinë e të dhënave; Declaration of responsibility for the accuracy of the information; - Certifikatë martesë; Marriage certificate; - Certifikatë bashkëjetese; Cohabitation certificate; - Certifikatë lindjeje për fëmijët e bashkëshortit ose bashkëjetuesit nën 21 vjeç; Birth certificate for the spouse's or cohabiting partner's children under 21 years of age; - Kopje e Certifikatës së Regjistrimit (të anëtarit të familjes shtetas të BE); Copy of the Registration Certificate (of the EU citizen family member);

## SEKSIONI C / SECTION C

<b>4 Informacion plotësues për Aplikimin / Additional information for the application</b>
<p><b>A keni qenë ndonjëherë i dënuar për një veprë penale dhe sa jeni dënuar?</b> Have you ever been convicted of an offence and sentenced to punishment?</p> <p><input type="checkbox"/> Jo/ No</p> <p><input type="checkbox"/> Po, specifiko veprën penale dhe sa jeni dënuar / Yes, specify the offence and sentenced to punishment</p>
<p><b>A vuani nga ndonjë sëmundje?</b> Do you suffer from any diseases?</p> <p><input type="checkbox"/> Jo/ No</p> <p><input type="checkbox"/> Po, specifiko sëmundjen: / Yes, specify the disease:</p>

## SEKSIONI Ç / SECTION Ç

<b>5 Deklarime perfundimtare / Last declarations</b>	
<div style="border: 1px solid black; width: 100px; height: 100px; margin: 0 auto; display: flex; align-items: center; justify-content: center;"><p>Foto Photo</p></div>	<p>Unë po aplikoj për një kartëqëndrimi në Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj, konfirmoj me nënshkrimin tim që informacioni i paraqitur në këtë aplikim dhe shtojcat e tij janë korrekte dhe te sakta. Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacioni të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një veprë e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e lejes së qëndrimit ose të heqjes së lejes ekzistuese, riatdhesimi dhe refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipërisë.</p> <p>I am applying for a Albanian residence card and hereby affirm with my signature that the information I submit in this application and its appendices is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a residence permit or the cancelling of an existing permit, repatriation and the refusal of entry into the Albanian territory.</p>
<p><b>Vendi dhe data</b> Place and date _____</p>	<p><b>Nënshkrimi</b> Signature _____</p> <p style="text-align: center;"><small>Emri në shkronja kapitale    Name in block letters</small></p>

---

## SEKSIONI D / SECTION D

### 4 Shtojca të detyrueshme / Obligatory appendices

Bashkëngjitni sqarimet me aplikimin dhe shënoni kutitë poshtë si të përshtatshme.  
Enclose the clarifications with the application and tick the boxes below as appropriate.

- Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit**  
Photocopy of valid travel document)
- Dy fotografi (47mmX36mm) të bëra jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit**  
Passport photo (47mmX36mm),
- Sqarim për akomodimin (dokumentacionet të përmendura në pikën 3.3)**  
Clarification of accommodation (documentation referred to in point 3.3)

---

## SEKSIONI E / SECTION E

### 7 Për tu plotësuar nga zyrtari që pranon aplikimin To be filled out by the official person to whom the application was submitted

Tipi i lejes që përfitohet:

**Kartëqëndrim** afati: \_\_\_\_\_ muaj

\_\_\_\_\_, më: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi i zyrtarit: \_\_\_\_\_

Formulari standard i aplikimit të certifikatë së regjistrimit



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË  
BRENDSHME

Certifikatë  
regjistrimi  
Registration  
Certificate  
Application

## APLIKIM PËR CERTIFIKATË REGJISTRIMI / REGISTRATION CERTIFICATE APPLICATION

Ky formular është për të aplikuar për certifikatë regjistrimi në Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes dhe nënshkruani aplikimin. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Aplikimi mund të paraqitet në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit në Shqipëri, ku ju keni vendbanimin.

This form is for applying for a Albanian registration certificate. Carefully fill in and sign the application. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. An application may be submitted to the Regional Directorate of Border and Migration in Albania, where is your residence.

Unë po aplikoj për  certifikatë regjistrimi për herë të parë  
I am applying for a first registration certificate

dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:  
and hereby submit the following information for the processing of my application:

### SEKSIONI A / SECTION A

<b>1 Informacion mbi aplikantin / Information on applicant</b>			
<b>1.1 Informacion mbi pasaportën ose dokumentin e udhëtimit</b> Information on Passport or travel document			
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportës: / Passport no.		
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportës Shërbimi /Official passport no.		
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaporte për te huajt / Alien's passport no.		
<input type="checkbox"/>	Dokument tjetër, specifikoj llojin dhe Numrin / Other, specify type and no.		
Vendi i lëshimit Country of issue	Autoriteti i lëshimit Authority of issue	Data e lëshimit Date of issue	Data e skadimit Date of expiry
<b>1.2 Te dhëna personale / Personal data</b>			

Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Emri i nënes Mother's name		Emri i babait Father's name	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shteti i lindjes Country of birth		Vendi i lindjes / Place of birth	
Gjinia /Gender:	<input type="checkbox"/> Mashkull / Male <input type="checkbox"/> Femër / Female <input type="checkbox"/> E panjohur / Unknoën		
Shtetësia (të) / Current citizenship(s)			
Gjendja Civile / Civil status	<input type="checkbox"/> Martuar / Married <input type="checkbox"/> Beqar / Single <input type="checkbox"/> Divorcuar / Divorced <input type="checkbox"/> I(e) Ve / Ëidoë(er) <input type="checkbox"/> Partner Civil / Civil Partner		
Profesioni dhe /ose trajnimi: Occupation and/or training:		Gjuha mëmë: Mother Tongue:	
<b>1.3 Informacioni i kontaktit të aplikantit / Contact Information of Applicant</b> Nëse informacioni i kontaktit ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj. If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.			
Adresa 1 / Address 1		Adresa 2 / Address 2	
Rruga, Nr. Street, No.			
Fshati/Qyteti -Shteti City/Toën - Country			
Tel. /Cel./Fax			
E-mail			
<b>2 Informacion mbi anëtarët e familjes / Information on family members</b> <b>2.1 Bashkëshorti ose Partneri civil/ Spouse or civil partner</b> <input type="checkbox"/> I pamartuar /No spouse			
Mbiemri / Family name :	Emrat / First names:		
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		Id Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shtetësia (te) aktuale Current citizenship(s)			
Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati) Address (street, no, city/country)			
<b>2.2 Fëmijë të mitur në kujdestari / Underage in my care</b> <input type="checkbox"/> Nuk kam fëmijë në kujdestari No children in my care			
Emri / First name	Mbiemri /Family name	Datëlindja (ddmmyyyy) Date of birth	
			<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application
			<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application
			<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application

<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application	
<input type="checkbox"/> Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application	
Nëse keni me shumë se pesë fëmijë, futni informacionin e fëmijëve të mbetur në një aneks të veçantë If you have more than five children, enclose the information on the remaining children in a separate appendix.	
<b>2.3 Banesa / Residence</b>	
Ambjenti i banimit: Place of residence:	<input type="checkbox"/> Garsonierë Studio apartments <input type="checkbox"/> Ambient kolektiv, pensione /hotel Collective accommodation/hotel <input type="checkbox"/> Apartament me dhoma Apartment With rooms
Unë kam bashkëngjitur kontratën e qerasë / dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin I am enclosing with the application the rent contract / proof of property	

## SEKSIONI B / SECTION B

<b>3. Informacion mbi qëndrimin në Shqipëri / Information on residence in Albania</b> <b>3.1 Arsyet e qëndrimit/ Grounds for residence</b>	
Kur dhe në cilin PKK keni hyrë në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? / Ehen and in which BCP did you enter to Albania?	
Datë/Date:	PKK/ BCP:
a) Punëmarrës Employee b) J vetëpunësuar Self-employed person c) Person me burime të mjaftueshme Person with sufficient resources ç) Student Student d) Anëtar familjeje i shtetasit të BE-së Family member of an EU citizen	
<b>3.2 Afati i qëndrimit / Terms of stay</b>	
Unë aplikoj për certifikatë regjistrimi me afat / I'am applying for a registration certificate	
<b>3.3 Unë kam bashkëngjitur vërtetimet e mëposhtme sëbashku me aplikimin:</b> I am enclosing the following clarifications with my application:	


<p><b>Punëmarrës ose i vetëpunësuar</b>  <b>Employee or Self-employed person</b>  <b>i)kontratë pune ose deklaram i punësimit nga punëdhënësi;</b>  <b>Employment contract or declaration of employment from the employer;</b>  <b>ii)paraqet dokumentacion që vërteton veprimtarinë e vetëpunësimit në Republikën e Shqipërisë.</b>  <b>Submission of documentation proving self-employment activity in the Republic of Albania.</b>  – NIPT (në rastet kur është i vetëpunësuar);  NIPT (in cases where the applicant is self-employed);  <b>b) Person me burime të mjaftueshme</b>  Person with sufficient resources  <b>i)deklaron dhe vërteton zotërimin e burimeve të mjaftueshme financiare për veten dhe anëtarët e familjes, që të mos bëhen barrë për sistemin e ndihmës sociale;</b>  <b>Declares and proves possession of sufficient financial resources for themselves and their family members, so as not to become a burden on the social assistance system;</b>  <b>ii)zotëron policë të vlefshme të sigurimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.</b>  <b>Holds a valid health insurance policy in the Republic of Albania.</b>  <b>c) Student</b>  <b>Student</b>  <b>i)vërtetim regjistrimi nga institucioni arsimor;</b>  <b>Certificate of enrollment from the educational institution;</b>  <b>ii)policë sigurimi shëndetësor;</b>  <b>Health insurance policy;</b>  <b>iii)deklarata ose dokument provues për burime të mjaftueshme financiare.</b>  <b>Declaration or supporting document proving sufficient financial resources.</b>  <b>ç) Anëtar familjeje i shtetasit të BE-së</b>  <b>Family member of an EU citizen</b>  <b>i) shoqëron ose bashkohet me shtetasin e BE-së</b>  <b>Accompanies or joins the EU citizen</b></p>
--

## SEKSIONI C / SECTION C

<p><b>4 Informacion plotësues për Aplikimin / Additional information for the application</b></p>
<p>A keni qenë ndonjëherë i dënuar për një vepër penale dhe sa jeni dënuar?  Have you ever been convicted of an offence and sentenced to punishment?</p> <p><input type="checkbox"/> Jo/ No</p> <p><input type="checkbox"/> Po, specifiko veprën penale dhe sa jeni dënuar / Yes, specify the offence and sentenced to punishment</p>
<p>A vuani nga ndonjë sëmundje?  Do you suffer from any diseases?</p> <p><input type="checkbox"/> Jo/ No</p> <p><input type="checkbox"/> Po, specifiko sëmundjen: / Yes, specify the disease:</p>

## SEKSIONI Ç / SECTION Ç

### 5 Deklarime perfundimtare / Last declarations



Unë po aplikoj për një certifikate regjistrimi në Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj, konfirmoj me nënshkrimin tim që informacioni i paraqitur në këtë aplikim dhe shtojcat e tij janë korrekte dhe të sakta. Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacioni të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një veprë e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e lejes së qëndrimit ose të heqjes së lejes ekzistuese, riatdhesimi dhe refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipërisë.

I am applying for a Albanian registration certificate and hereby affirm with my signature that the information I submit in this application and its appendices is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a residence permit or the cancelling of an existing permit, repatriation and the refusal of entry into the Albanian territory.

Vendi dhe data

Place and date \_\_\_\_\_

Nënshkrimi

Signature \_\_\_\_\_

Emri në shkronja kapitale Name in block letters \_\_\_\_\_

## SEKSIONI D / SECTION D

### 4 Shtojca të detyrueshme / Obligatory appendices

Bashkëngjitni sqarimet me aplikimin dhe shënoni kutitë poshtë si të përshtatshme.

Enclose the clarifications with the application and tick the boxes below as appropriate.

Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit

Photocopy of valid travel document)

Dy fotografi (47mmX36mm) të bëra jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit

Passport photo (47mmX36mm),

Sqarim për akomodimin (dokumentacionet të përmendura në pikën 3.3)

Clarification of accommodation (documentation referred to in point 3.3)

## SEKSIONI E / SECTION E

### 7 Për tu plotësuar nga zyrtari që pranon aplikimin

To be filled out by the official person to whom the application was submitted

Tipi i lejes që përfitohet:

Certifikate regjistrimi

afati: \_\_\_\_\_ muaj

\_\_\_\_\_, më: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i zyrtarit: \_\_\_\_\_